



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 146/2 Prot

Tiranë, më 10.06.2021

V E N D I M

Nr.68, datë 10.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 12277, datë 1.7.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 146 prot., datë 16.2.2021, nga nëpunësi doganor ***** , është ngritur pretendimi se, transferimi i tij i përkohshëm për nevoja të institucionit, në pozicionin “Doganier, Zyra Doganore Tushemisht”, në Degën Doganore Qafë-Thanë, është kryer në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, pasi ai ishte nëpunës civil në periudhë prove.

Nisur nga ky informacion, Komisioneri vlerësoi se ka shkak për dyshim të arsyeshëm për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil dhe filloi procesin e verifikimit. Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezultoi e vërtetuar që, nëpunësi doganor ***** , pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit,

është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Doganier, Zyra Operacioneve Doganore*”, Dega Doganore Qafë-Thanë, me aktin nr.6198/28, datë 28.10.2019, të Departamentit të Administratës Publike. Mbi këtë bazë, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, ka nxjerrë aktin nr. 26994/1, datë 29.10.2019, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm dhe pas mbarimit të periudhës së provës, është konfirmuar nëpunës civil, sipas vendimit nr.1529 prot., datë 21.12.2020, të eprorit direkt.

Pasi ka marrë emërimin në pozicionin “*Doganier, Zyra Operacioneve Doganore*”, Dega Doganore Qafë-Thanë, rezulton se, për nevoja të institucionit, me aktin nr. 12277, datë 1.7.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësi në fjalë, është transferuar përkohësisht për nevoja pune, në pozicionin “*Doganier, Zyra Doganore Tushemisht*”, brenda Degës Doganore Qafë-Thanë (ku vazhdon të punojë aktualisht).

Në kërkesën e tij, punonjësi doganor *****, ngre pretendimin se, ky transferim është kryer në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, sipas të cilit nuk lejohet transferimi i përkohshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove, megjithëse ai ka zbatuar urdhrin duke filluar të kryejë detyrën në atë pozicion.

Ndërkohë, është parashtruar pretendimi tjetër sipas të cilit, meqënëse afati 6-mujor i transferimit të përkohshëm që parashikon ligji në këtë rast, është tejkaluar dukshëm dhe ndodhur në kushtet kur nga ana e institucionit nuk është vepruar për kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, të paktën të ndërhyhet nga ana e Komisionerit, për tu rivendosur gjendja e ligjshmërisë, duke e kthyer në vendin e punës si “*Doganier, Zyra Operacioneve Doganore*”, Dega Doganore Qafë-Thanë, ku ka emërimin e rregullt.

Nisur nga sa më sipër, u arrit në përfundimin se kishte vend për dyshime të arsyeshme për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, prandaj Komisioneri mori vendim për fillimin e procesit të verifikimit. Nga hetimi administrativ i këtij rasti rezulton se, emërimi i punonjësit doganor *****, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Doganier, Zyra Operacioneve Doganore, Dega Doganore Qafë-Thanë*”, është bërë pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, neni 13, pika 3, ku parashikohet se, pranimi i personelit në administratën doganore për pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil, bëhet sipas parimeve të këtij kodi, mbi bazën e procedurës të përcaktuar në nenin 15, pika 3, të ligjit, si dhe në Kreun I, “*Pranimi në administratën doganore*”, të Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për personelin e administratës doganore*”, i ndryshuar.

Përsa i përket periudhës së provës, nga përmbajtja e akteve ligjore si më sipër, rezulton se për punonjësit doganorë që janë në periudhë prove, zbatohen rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (pika 8, neni 15, i Kodit, si dhe pika 5, Kreu I, VKM nr.921, datë 29.12.2014, e ndryshuar), i cili, nuk e lejon transferimin e përkohshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove, e parashikuar në pikën 3, shkronja “a”, Kreu I, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, i cili ka dalë në zbatim të ligjit për nëpunësin civil.

Në rastin e punonjësit doganor *****, nga këqyrja e akteve të administruara, rezulton se, ndërsa punonjësi në fjalë ishte në periudhë prove, e cila sipas pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, zgjat një vit, pa mbaruar ky detyrim ligjor, ai është transferuar përkohësisht në një pozicion tjetër brenda Degës Doganore Qafë-Thanë, duke ruajtur të njëjtën kategori (emëruar datë 29.10.2019 dhe transferuar datë 1.7.2020).

Ky është një veprim i paligjshëm i administratës doganore, pasi transferimi i përkohshëm në një pozicion tjetër në kushtet e periudhës së provës, mund të çënojë ecurinë profesionale të nëpunësit, uljen e përqëndrimit, mungesën e ndjekjes dhe këshillimit nga ana e nëpunësit kujdestar, etj., të cilat mund të kenë ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në nivelin dhe cilësinë e rezultateve individuale në punë.

Megjithatë, në kushtet kur aktualisht, periudha e provës ka përfunduar dhe nëpunësi është konfirmuar si nëpunës civil, nuk është e nevojshme që Komisioneri të shprehet për marrjen e masave konkrete për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, përsa i përket procesit të kryerjes së periudhës së provës. Shkelja e pikës 3, shkronja “a”, të Kreut I, të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, në këtë rast, shërben për ti tërhequr vëmendjen drejtuesit të institucionit dhe njësisë së burimeve njerëzore që një gjë e tillë, të mos përsëritet në të ardhmen, në raste të ngjashme.

Në këto rrethana, vlerësohet i drejtë pretendimi i kërkuesit se, transferimi i përkohshëm në kushtet kur vazhdonte periudha e provës, është kryer në kundërshtim me legjislacionin për nëpunësin civil, por meqënëse ky vendim, nuk ka ndikuar në ecurinë e nëpunësit, i cili është konfirmuar rregullisht si nëpunës civil, mbetet që Komisioneri të shprehet vetëm për problemin e tejkalimit të afatit 6-mujor të transferimit të përkohshëm që parashikon ligji në këtë rast.

Është me vend të thuhet këtu se, transferimet e përkohshme të punonjësve doganorë, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, kryhen sipas parimeve,

kushteve dhe procedurave specifike të Kodit Doganor, parashikuar në pikën 3, të nenit 13, të tij. Konkretisht, në pikën 7/a, të nenit 15, të Kodit Doganor, parashikohet: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njejtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj; ...

dhe më tej, në pikën 7/c, të nenit 15, të Kodit, përcaktohet në mënyrë të shprehur: *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”.*

Në rastin konkret, në kushtet kur vërtetohet që afati 6-mujor i transferimit të nëpunësit ***** , ka përfunduar në muajin Dhjetor 2020 dhe tashmë është tejkaluar, si dhe kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligj, ky punonjës duhej të ishte rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, duke theksuar faktin se, nëpunësi doganor mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet e transferimit dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës *“Doganier, Zyra Operacioneve Doganore”*, Dega Doganore Qafë-Thanë, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, në zbatim të shkronjës “a”, pika 7, të nenit 15, të ligjit nr.102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të mbajë parasysh vërejtjen e përshtuar në pjesën arsyetuese të vendimit, për moslejimin e transferimit të përkohshëm të

- nëpunësve doganorë gjatë periudhës së provës dhe nga ana tjetër ka detyrimin të krijojë kushtet e nevojshme dhe të ndjekë procesin e zbatimit të këtij vendimi.
3. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **15** ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
 4. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
 6. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njësia e burimeve njerëzore të institucionit dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha